

Prof. Dr. Masar RIZVANOLLI

ZHVILLIMI I ARSIMIT SHQIP NË GJAKOVË DERI MË 1918

Gjakova ka një traditë të pasur të arsimit dhe të kulturës, traditë, e cila filloi qysh me fillimin e jetës qytetare në te, qysh kur Sylejman Hadim aga ndërtoi dhe vakëfoi, në vitin 1003 H (1594/1595), pos hanit, hamamit dhe disa dyqaneve, një xhami, një shkollë (mejtep), një bibliotekë dhe një muvakit-hane, një “objekt për matjen e kohës dhe për caktimin e kalendarit me ndihmën e kuadranteve astrolabike”. Për mirëmbajtjen e këtyre objekteve kërkoi nga sulltani një pjesë të haseve sulltanore.¹ Sipas traditës gjakovare biblioteka e Hadim agës ishte aq e pasur me libra sa që thuhej se “kush donë me e pa Çaben le ta vizitojë bibliotekën e Hadum agës”². Ajo ishte ndërtuar, ngjit me minaren, duke mbyllur tërësisht, në anën e djathtë, oborrin e kompleksit të xhamisë. Në pjesën përdhese të saj ishte salla e leximit, ndërsa në kat gjendeshin vitrinat me libra.³ Ajo ishte më e madhe se vet xhamia.⁴

1 Nehat Krasniqi, *Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane*, “Vjetar”, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 2006, XXXV-XXXVI, f. 216. Dr. Hasan Kaleshi - Dr. Hans Jürgen, *Vilajeti i Prizrenit*, “Përparimi” (Revistë kulturore dhe shkencore), Prishtinë, 1967, nr. 3., f. 280-281.

2 Ibrahim Zherka, *Gjakova ç' prej themelimit dhe ngjarjet historike ma me randësi në te*, (Dorëshkrim), Arkivi i Kosovës. K-13/7. Nr. 458 (Deklarata të Beqir Haxhibeqirit, Xheladin Komonit, Fahri efendi Iljazit e shumë pleqve të tjerë “esnafë”, të Çarshisë së Madhe të Gjakovës).

3 Nađa Kurtović-Folić, *Studija o revitalizaciji velike čarsije u Djakovici*, Antikitetet e Kosovës, Vëllimi VIII. Enti Krahinor i Mrojtyes së Monumenteve të Kulturës., Prishtinë, 1987, f. 11.

4 Në intervisten e tij, eksperti i artit islam, drejtori i Qendrës Dokumentare të Artit

Më vonë zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në Gjakovë e ndihmuan pjesëtarët e familjes Kurtpasha, disa nga të cilët ndërtuan xhami, mejtepe dhe medrese.⁵

Kjo traditë fitoi dimensione të reja duke u pasuruar dhe thelluar në mënyrë të veçantë në vitet e bujshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në të cilën Gjakova me rrethinë dha ndihmesën e saj të spikatur. Sipas disa të dhënave shkollat shqipe u hapën në Prizren, në Gjakovë dhe në Pejë “shumë para v. 1840.”⁶ Por tash për tash nuk jemi në gjendje t’i caktojmë kufijtë kohorë të shprehjes “shumë para v. 1840”. Dimë për ekzistencën e shkollave private dhe të mësuesve misionarë françeskanë në Gjakovë, në Zym dhe në Pejë që nga fillimi i shek. XVIII. ⁷ Dimë, gjithashtu, se Gjon Nikollë Kazazi, doktor i teologjisë e i filozofisë dhe arqipeshkëv i dioqezës së Shkupit e kishte hapur një shkollë private në shtëpinë e tij në Gjakovë para vitit 1743.⁸ Në këtë shkollë përgatiteshin ata të rinj, të citët do t’i fillonin studimet e rregullta në kolegjet e ndryshme papnore në Itali. ⁹ Ai përmend emrat e shtatë djelmoshave prej moshës shtatë deri në katërbëdhjetë vjeçare, të cilët kishte arritur për

Islam dhe të Arkitekturës Islame, pranë Universitetit të Harvardit, prof. Ridlmajeri, ndër të tjera, pohon: “Xhamia e Hadumit është monument unikat në të gjitha trojet shqiptare. Është i vetmi kompleks i këtij lloji që është ruajtur. Xhamia e Hadumit nuk është vetëm xhami, por është qendër kulturore. Pranë xhamisë gjendej biblioteka, e cila ishte më e madhe se vet xhamia. Pranë bibliotekës gjendej mejtepi, ndërsa aty pranë Çarshia e Vjetër me dhjetra dyqane, të cilat ishin vakëfe të xhamisë. I tërë kompleksi, pra, përbënte një qendër edukative e fetare. Kompleksi ishte ndërtuar e zhvilluar nga ana e vetë gjakovarëve. Kjo qendër nuk ishte e importuar nga jashtë. Ky është monument i kulturës shqiptare...” “Dituria Islame”, Prishtinë, 2000, nëntor, dhjetor, nr. 125, 126., f. 39-40.

5 Cf. N. Krasniqi, *Roli i fisnikërisë...*, f. 216-218.

6 Dr. Jashar Rexhepagiq, *Zhvillimi i arësimit dhe i sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1970, f. 152. Dr. Ali Hadri, *Gjakova prej themelimit deri më 1941*, Kosova 1, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1972, f. 391.

7 Bardhyl Demiraj, *Jeta dhe veprimtaria e Gjon Pagëzues Nikollë Kazazit*, Studime, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2005, 11/2004, f. 351. Cf. Gjini Gasper, *Skopsko-Prizrenska biskupija kroz stoljeća*, Zagreb, 1986, st. 175.

8 Op. cit. 350. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 70.

9 Bardhyl Demiraj, Gjon P. Nikollë Kazazi dhe “Doktrina” e tij. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë, 2006, f. 36. Idem, *Jeta dhe vep. e Gj. N. Kazazit...*, f.381.

t'i shkëputur “nga vatra prindërore për t'i edukuar – jo pa stërmundime – për punët e kishës”¹⁰.

Ndër detyrat kryesore që ia kishte shtruar vetes Kazazi ishte jo vetëm përgatitja e misionarëve vendës në kolegjet fetare italiane, por edhe kthimi i tyre në vendlindje për t'i plotësuar nevojat e dioqezës, “duke u përkujdesur pa kurrfarë lodhje për shëndetin e shpirtit”, sepse ishin “pikërisht këta nxënës ata që nuk braktisin atdheun dhe misionet dhe qëndrojnë aty deri në vdekje e në pikën e fundit të gjakut, siç dëshmojnë gjithë ata shembuj të kohëve moderne dhe antike”. Ai vazhdonte më tutje, “se në kohë persekutimesh të ndryshme ose në kohë lufte, ata që nuk janë vendas ose largohen vetë, ose përzihen nga pushteti publik. Vetëm vendasit tëharrin në mbikëqyrjen e misionit dhe të besimtarëve”¹¹.

Prandaj, ai i lutej Kongregatës së Shenjtë që për dioqezën e tij të dërgojë “të paktën vetëm tre studentë që të fillojnë menjëherë, sapo të jenë kthyer (në dioqezë) me mësimdhënien”, ndërsa ushqimin dhe veshjen për nxënësit do ta siguronte vetë “për sa kohë të jem gjallë”¹². Njërin nga mësimdhënësit, që do të dërgoheshin në shkollën e tij, do ta caktonte “jo vetëm për gjuhën latine, siç ka për qëllim Kongregata e Shenjtë, por në të njëjtën kohë edhe për mësimin e shkronjave (= gjuhës) ilirike, që janë shumë të nevojshme” sepse “misionarët tanë duhet të dinë tri gjuhë, d.m.th. gjuhën shqipe, ilirishten (=sllavishten) dhe turqishten, pa të cilat një misionar nuk mund të plotësojë si duhet nevojat e zakonshme të atyre popujve”¹³.

Pas një sëmundjeje të rëndë njëvjeçare, Gjon Nikollë Kazazi vdiq, më 5 gusht 1752, pranë Zef Lumbeshit, mësimdhënësit në shkollën e Gjakovës, i cili për asnjë çast nuk iu nda deri në frymën e fundit. Në kumtin e tij me shkrim për vdekjen e mësuesit të tij, ndër të tjera, lexojmë: “...Pastaj si ndihmës që kam qenë për imzotin në punët e tij, kam mbetur tashmë në misionin e Gjakovës, ku kam të drejtën që t'i jap mësim ndonjë fëmije...”¹⁴

Sa ishte gjallë, Kazazi arriti të hapë shkolla fetare në dioqezën e

10 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...* f. 70. B. Demiraj, *Gj.P.N. Kazazi dhe “Doktrina” e tij...* f. 106-107.

11 B. Demiraj, *Gj.P.N. Kazazi dhe “Doktrina” e tij...*, f. 107-108.

12 Op. cit. 108-109. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 70.

13 Op. cit. 109. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 70.

14 Op. cit. 111-112. B. Demiraj, *Jeta dhe vep. Gj.N. Kazazit...*, f. 383.

tij, duke angazhuar si mësues ish nxënësit e tij, të diplomuar në kolegjet e Kongregatës së Shenjtë si Zef Lumbeshin, Mati Krasniqin dhe Zef Berishë Nikollën, të cilët punuan si mësues në misionet e Gjakovës, të Janjevës, të Zymit etj.¹⁵ Punën në shkolla ata e vazhduan edhe pas vdekjes së mësuesit të tyre. Në këto shkolla nxënësit shqiptarë mësonin rregullisht shkrimleximin në gjuhën shqipe dhe doktrinën e krishterë, gjithashtu në shqip, të hartuar nga Gjon Nikollë Kazazi dhe të botuar në shtypshkronjën e Propagandës së Shenjtë¹⁶.

Për marrëdhëniet gjuhësore ndëretnike në dioqezë mësojmë nga një letër falënderimi të Zef Berishë Nikollës, dërguar, më 28 maj 1782, Kongregatës së Shenjtë, në të cilën lexojmë edhe këtë: "Më erdhi kaseta e shumëpritur me disa doktrina shqip dhe me disa libra... në gjuhën ilirike (sllave), të cilat nuk mungova t'i shpërndaja në Pejë, disa në Prizren... Për më tepër, këtu në Gjakovë nuk është se kam nevojë për sosh në gjuhën ilirike, por vetëm syresh në shqip"¹⁷.

Gjon Nikollë Kazazi interesohej edhe për sigurimin e teksteve themelore në gjuhën shqipe për shkollat e dioqezës së tij. Gjatë vizitës së tij në Romë, ai kërkoi nga Kongregata e Shenjtë, më 1740, një sasi librash mësimi, ndër të cilat edhe 30 copë doktrina të Bellarminit, të përkthyer shqip nga Pjetër Budi, sepse në dioqezë, sipas tij, "flitet gjuha shqipe dhe ky numër doktrinash është i nevojshëm për të rinjtë"¹⁸. Më vonë, më 1743, ai përgatiti dhe botoi një doracak katekistik, kushtuar fëmijëve të krishterë, "Doktrina e Kështen"¹⁹. Ky tekst "përbën një thesar të pallogaritshëm në fondin historik të kulturës së shkrimit shqip"²⁰. "Përhapja dhe përdorimi i saj (Doktrinës së Krishterë-MR), e pse jo për të gjithë besimtarët e thjeshtë, nuk mund të kuptohet ndryshe, veçse si një ndërhyrje e vetëdijshme e Kazazit për të thyer atë barrierë gjuhësore që pengonte si bashkësinë katolike shqiptare ashtu edhe klerin e ulët

15 Op. cit. F. 115-116.

16 Op. cit. 116. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 69.

17 Op. cit. 116-117. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...* f. 70.

18 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit shqip...*, f. 69. B. Demiraj, *Gj.P.N. Kazazi dhe "Doktrina" e tij...*, f. 55.

19 Titulli italisht në ballinën e librit: "Përmbledhje e shkurtër e Doktrinës së Krishterë. Përkthyer në gjuhën shqipe për dobinë dhe arsimimin e fëmijëve të këtij kombi..." B. Demiraj, *Gj. P. N. Kazazi, dhe "Doktrina" e tij...*, f.143. Cf. J.Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f.69.

20 B. Demiraj, *Gj. P. N. Kazazi dhe "Doktrina" e tij...*, f. 115.

katolik shqiptar në njohjen dhe përvetësimin e fesë së krishterë sipas rritit katolik roman”²¹ Kjo vepër si burim “mbetet ende sot ndoshta ma i vjetri dokument shqip, botue në dialektin e Gjakovës”²²

Të përmendim për fund se veprimtaria e Gjon Nikollë Kazazit u kurorëzua me sukses të plotë. Nga gjashtë klerikët vendës të personelit të Dioqezës së Shkupit, në vitin e vdekjes së tij, më 1752, pesë syresh – Zef Lumbeshi, Mati Mazrek Krasniqi, Zef Berishë Nikolla, Pjetër Berisha dhe Pjetër Zogaj - ishin nxënës të cilët i kishin marrë mësimet e para nga vetë Gjon Nikollë Kazazi.²³

Shënime të sakta për shkollën shqipe, të hapur pranë kishës katolike në Gjakovë kemi që nga viti 1851. Në këtë shkollë dhanë mësim Don Pjetër Doda, Don Filip Kanxhi, Don Tom Gusiqi, Patër Rozarja, Patër Gaudenci, Don Pjetër Zara, Don Ndue Bytyçi etj., ndërsa mësues laikë ishin Pashko Logoreci dhe Mihill Kurti. Kjo shkollë si dhe shumë të tjera gëzonte ndihmën e Austrisë²⁴. Që të gjithë mësuesit, e bartën apo jo petkun fetar, vepronin në bazë të parimeve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kishte midis tyre autorë poezish fetare dhe patriotike siç ishte Don Ndue Bytyçi, i cili nëpërmjet të poezisë së tij, ftonte bashkatdhetarët të vazhdonin rrugën e luftës për liri. Ai pati lidhje dhe bashkëpunoi në fushën e mendimit letrar rilindës me poetë të tjerë bashkëkohës, madje edhe me arbëreshë siç ishte Leonardo de Martino²⁵.

21 Op. cit. 135.

22 Hylli i Dritës, nr. 11/1934. 574. Cituar sipas J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 69.

23 B. Demiraj, *Jeta dhe vep. e Gj. N. Kazazit...*, f. 381. Idem, *Gj. P. N. Kazazi dhe "Doktrina" e tij...*, f. 106.

24 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 153. A. Hadri, *Gjakova deri më 1941...*, f. 391. Dr. Jashar Rexhepagiq, *Shkollat dhe arësimi në Kosovë nga fundi i shekullit XVIII gjer më 1918*, Në: Kosova I. Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1972, f. 182.

Sipas A. Nikiqit, në vitin 1865 në Gjakovë ekzistonte shkolla në të cilën mbanin mësim, kur ishin të lirë, fra Marijani nga Palmanova, don Filip Kanci dhe don Toma Ivankoviqi pa pagesë. Më 1872 shkollën e mbante një motër, e cila i merrte nga Austria 210 forinta. Shkollën e vijonin 20-30 nxënës. Në këtë shkollë mësohej leximi e shkrimi, aritmetika dhe mësimi i krishterë. Andrija Nikiç, *Stanje u Sjevernoj Makedoniji i Kosovu od god. 1860 do 1890 u svjetlu novih izvora, Makedonija na Istočnata Kriza 1875-1881*, Makedonska Akademija Nauka i Umetnosti, Skoplje, 1978, st. 196.

25 Dr. Muhamet Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1989, f. 431-432.

Merita të veçanta për hapjen e shkollave shqipe në Prizren e Gjakovë kishte Andre Logoreci, i cili solli nga Shkodra nipat e vet. Në Gjakovë dërgoi të vëllanë Pashko Logorecin, i cili filloi nga puna që nga viti shkollor 1889-1890.²⁶ Të theksojmë se në konfliktin që plasi në Prizren ndërmjet popullsisë vendëse dhe konsullatës austro-hungareze rreth shkollës që subvencionohej nga Vjena, e cila solli aty misionarë fetarë kroatë për të mbajtur mësimet në gjuhën sllave, konflikt që e arriti kulmin më 1898, banorët e Gjakovës mbështetën kërkesat e prizrenasve për pezullimin e mësimet të sllavishtes. Në një letër të tij patrioti i shquar, mësuesi i shkollës së Prizrenit, Mati Logoreci shprehej, me këtë rast, se gjakovarët “nuk jan gjin qi durojn, pse ner ta lun martina”.²⁷

Pas viteve 30 të shek. XIX, në frymën e reformave të Tanzimatit, në Gjakovë u hapën shkollat shtetërore turke: shkollat fillore (iptidajet) dhe gjimnazet e ulëta (ruzhdijet). Sipas sallnamesë së vitit 1893 në Gjakovë kishte 15 shkolla fillore (iptidaje), me 1101 nxënës dhe një gjimnaz të ulët (ruzhdije) me 120 nxënës.²⁸ Më 1900 kanë ekzistuar edhe dy ruzhdije.²⁹

Nxënësit e shkollave fillore shtetërore mësonin nga librat, të cilët ishin të shkruar në gjuhën turqishte, të pakuptueshme për nxënësit gjakovarë, të cilët flisnin vetëm shqip në shtëpitë e tyre. Prandaj, mësuesit e tyre, që ishin, kryesisht gjakovarë, ua përkthenin këto tekste fshehurazi në gjuhën amtare, ndonëse shkrimi dhe leximi në gjuhën shqipe ishte rreptësisht i ndaluar. Këtë mund ta bënin për arsye se ndi-

N. Bytyçi, në vjershat e tij jo fetare “glorifikon punën dhe bukuritë natyrore”. Më 1887 botoi përmbledhjen “Memleqeti”, J. Rexhepagiq, Shkoll. dhe ars... f. 200.

26 Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Libri shkollor, Prishtinë, 2002, f. 184. A. Hadri, Gjakova deri më 1941... f. 391. J. Rexhepagiq, Zhvill. i arësimit... f. 165. Idem, Shkollat dhe arësimi shqip në Kosovë... f. 189.

Të përmendim se Ndue Paluca nga fshati Marmëll i Gjakovës ka punuar, pasi është kthyer nga Shkupi, si mësues në Prizren më 1912. Mësuesi i tij në Prizren, Mati Logoreci e kishte dërguar për shkollim në Austri. J. Rexhepagiq, Shkoll. dhe ars... f. 189.

27 Hysni Myzyri, *Shkollat e para kombëtare shqipe (1887-korrik 1908)*. “8 nëntori”, Tiranë, 1978, f. 192. Popullsisë së Prizrenit iu bashkuan edhe klerikët shqiptarë Pashko Trokshi e Ndue Bytyçi. Prizrenasit hapën, më 1899, një shkollë të re shqipe të pavarur me mësues M. Logorecin. Ibid. H. Koliqi, Hist. e arsimit... f. 185.

28 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 119. Idem, Shkoll. dhe ars... f. 124. A. Hadri, *Gjakova deri më 1941...*, f. 394.

29 Op. cit. f. 121.

kimi i autoriteteve qeveritare osmane ishte shumë i dobët në Gjakovë. Shpjegimi i mësimi dhe bisedat në klasë zhvilloheshin lirisht në gjuhën shqipe.³⁰

Intelektualët shqiptarë nga Gjakova, të shkolluar në qendrat më të rëndësishme arsimore të Perandorisë Osmane, patën një rol të veçantë në hapjen e shkollave në gjuhën shqipe gjatë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.³¹

Një rol të rëndësishëm në pasurimin e traditës arsimore në trevën e Gjakovës dhe më gjerë pati edhe hapja e shkollave fetare, në fillim e mejtepeve dhe, më vonë, e medreseve³². Medreseja e Madhe, një qendër e rëndësishme arsimimi dhe edukimi në frymën fetare dhe kombëtare, në të cilën vijuan mësimet me mijëra të rinj nga të gjitha trevat e Rrafshit të Dukagjinit, të Malësisë, të Hasit etj. u themelua qysh më 1707 nga alimi dhe bamirësi i madh Murat beu, i biri i Adem pashës, i cili kishte shërbyer si mytesarif në sanxhaqet e Ohrit, të Elbasanit dhe të Shkodrës.³³ Kjo shkollë punonte sipas programit të Fakultetit Teologjik "Fatih" të Stambollit.³⁴ Kishte një konvikt të madh dhe një bibliotekë të pasur³⁵. Nxënësit e kësaj medreseje i vazhdonin shkollat e larta në Stamboll dhe në Aleksandri.³⁶ Nga mësimdhënësit më të njohur të Medresesë së Madhe ishin Ali efendi Pera nga Gjakova, i njohur si myderriz i aftë dhe i arsimuar, pastaj Hasan efendi Shllaku, profesor fakulteti në Stamboll, i cili, për arsye familjare, u kthye në Gjakovë, Ali efendi Fikriu nga Gjakova, gjithashtu, profesor në Fakultetin Teologjik

30 Ibid.

31 A. Hadri, *Gjakova deri më 1941...*, f. 394.

32 Në vitin 1874 në Gjakovë kanë ekzistuar 17 mejtepe dhe Medreseja e Madhe dhe e Vogla. J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...* f.121.

33 Prof. Pleurat Krasniqi, *Aspekte kulturore-historike të Gjakovës dhe ixhazetlinjtë 1870-1940*, Gjakovë, 2002, f. 17; Nehat Krasniqi, *Dy dokumente gjenealogjike të rëndësishme*, "Dituria Islame", Prishtinë, 1994, nr. 59., f. 14. Idem, *Roli i fisnik. shqiptare...* ,f. 216-217; Cf. Mexhid Yveysi, *Kështjellat e gjakut tonë*, Gjakovë, 2000, f.11; J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 119.

34 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 119. Idem, *Shkoll. dhe ars...* f. 124; P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës...* ,f. 18.

35 J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f. 125.

36 Ibid.

“Fatih”.³⁷ Shquheshin edhe Vejsel efendiu, Jahja efendiu etj.³⁸

Nga nxënësit më të shquar duhet të përmendim Tahir efendi Llukën, profesor në Fakultetin Teologjik “Fatih” të Stambollit³⁹, Teufik Nahin, profesor universiteti në Kajro, Haxhi Zekën, veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare etj.⁴⁰

Arsimtarë dhe nxënës të Medresesë së Madhe u dalluan për ndihmesën që dhanë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare si Ismail efendiu, Ali efendiu dhe Hasan efendiu, bashkëpunëtorë të ngushtë të Sylejman Vokshit gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe nxënësi i përmendur i kësaj medreseje Haxhi Zeka, themelues i Lidhjes së Pejës.⁴¹

Medreseja e Madhe nuk arriti t’i plotësojë të gjitha nevojat e popullsisë së etshme të Gjakovës për dituri fetare dhe për edukatë atdhetare. Prandaj, Tahir efendi Boshnjaku themeloi, rreth viteve 1815-1816, Medresenë e Vogël, e cila e mori këtë emër vetëm pse u themelua më vonë se e Madhja, ndërsa për kah rëndësia, për kah hapësira apo për kah numri i nxënësve nuk ishte më e vogël se e para. Për shkak të famës që fitoi, këtë medrese e ndiqnin edhe nxënës nga rajonet e Sanxhakut të Jeni Pazarit, të Toplicës, të Plavës dhe të Bosnjës. Si myderrizë të njohur nga kjo medrese shquheshin, pos themeluesit të saj, Tahir efendiut, Fetah efendi Buza, Emin efendi Hoxha, Isuf efendi Çarkaxhija etj.⁴²

Duhet të nënvizojmë, me këtë rast, se në këto medrese mësimet zhvilloheshin në gjuhën shqipe, ndonëse literatura që përdorej ishte në gjuhën arabe apo osmane. Sipas J. Rexhepagiqit “disa nga mualimët dhe myderrizët gjakovarë provuan të përkthejnë veprat nga gjuha arabishte dhe turqishte në shqipet e disa madje edhe shkruan libra në gjuhën shq-

37 Op. cit. 120. P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 26.

38 J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f.125.

39 Cf. M. Pirraku, *Kult. komb. Shqiptare...*, f. 393; P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 101.

40 P. Krasniqi, *Aspekte kul.hist. të Gjakovës*, f. 26.

41 Cf. Prof. Dr. Masar Rizvanolli, *Veprimtaria e Ahmet efendi Koronicës gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Kosova 26, Instituti i Historisë-Prishtinë, Prishtinë, 2005, f. 166.

42 P. Krasniqi, *Aspekte kult. hist. të Gjakovës...*, f. 28-29; Cf. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 120. Sipas traditës Medreseja e Vogël u hap më 1777, 70 vite pas Medresesë së Madhe. U quajt Medrese e Vogël, sepse ishte e rangut më të ulët vetëm katër vjeçare, ndërsa në të Madhën, që ishte në rang fakulteti, mësimet vazhdonin tetë vite. Deklarata të Fahri efendi Iljazit, të Dr. Ali Iljazit etj.

ipe, por duke përdorur alfabetin arab.”⁴³ Në Medresenë e Madhe mësimet në gjuhën shqipe u zhvilluan edhe gjatë veprimtarisë së saj në periudhën e sundimit të Jugosllavisë së Vjetër, kur nuk kishte fare shkolla në gjuhën shqipe as që përdorej kjo gjuhë në institucionet publike.⁴⁴ Prandaj, në medresetë e Gjakovës u shkolluan, kryesisht, nxënësit nga shtresat e varfra fshatare, të cilët nuk e njihnin gjuhën turqishte, që nuk e flisnin në shtëpitë e tyre.⁴⁵ Kësisoj ato ndikuan në përhapjen e arsimit në ato shtresa shoqërore, të cilat, për shkak të rrethanave ekonomiko-shoqërore dhe politika mbizotëruese e periudhës së Tanzimatit, ishin plotësisht të përjashtuara nga çfarëdo mundësie për shkollim të mirëfilltë.

Myderrizët e dy medreseve nuk e kufizuan veprimtarinë e tyre vetëm në procesin e mësimdhënies, vetëm në ngritjen e kuadrove të reja. Ata ishin edhe autorë të njohur veprash fetare, didaktike dhe atdhetare, disa prej të cilave të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab. Ndër më të dalluarit ishte Tahir efendi Boshnjaku, autor i veprës në gjuhën shqipe “Emni Vehbije,” botuar në Stamboll më 1835 me shkronja arabe dhe të transliteruar e të transkribuar nga Ismail Haxhi Tahir Gjakova në alfabetin e Stambollit, botuar nga Mbrothësia e Sofjes më 1907.⁴⁶ Ka autorë, të cilët mendojnë se “Emni Vehbije” është shkruar më 1806.⁴⁷ Kjo vepër sipas disave iu kushtua nxënësve, ndërsa sipas të tjerëve iu kushtua hoxhallarëve për predikim në popull. Përmban fjalë të urta, që e kanë bazën në burimet biblike e kuranore, disa të përvetë-

43 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 120; P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 22.

Mulla Osmani nga Gjakova përmendet që në vitin 1789 për përshkrimin e një punimi të filozofit dhe të teologut arab Gazalit, i cili “ka mendime të vlershme pedagogjike, sepse ky është konsideruar si më i miri pedagog ndër shkrimtarët islam”. Op. cit. f.43.

44 Deklarata të Azem Hajdinit – Xanit dhe të Hajriz Demakut nga Drenica, nxënës të Medresesë së Madhe. Gjakovë, 4 qershor 2005.

45 Cf. P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 22.

46 M. Pirraku, *Kult. komb. shqiptare...*, f. 374-385; A. Hadri, *Gjakova deri më 1941*, f. 394; J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 136-137; P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 72-73.

47 M. Pirraku, *Kult. komb. Shqiptare*, f. 377-379, 381. Sipas M. Pirrakut Emni vehbije sherif do të thotë Porosi fisnike e dhuruar nga Zoti apo Dhiatë e ndershme e dhënë nga Zoti. Op. cit. f. 375.

suara nga shqiptarët. Këto paraqesin mendime që mund të hasën në kulturat e popujve të tjerë myslimanë e të krishterë.⁴⁸ Vend kryesor në këtë vepër zë kërkesa për përhapjen e mësimimit dhe të dijes. “Shkado me konë i keq - thuhet aty - xhahilleku osht ma i keq”⁴⁹ Kjo vepër, pos vlerave gjuhësore ka edhe vlera pedagogjike. Aty flitet për detyrimet e çdo njeriu, për normat fetare, për detyrat familjare, për moralin, për dijen, për mësimin...⁵⁰

M. Pirraku, nënvizon se “rëndësia kombëtare e kësaj vepre, për kohën kur është shkruar, fillimi i shek. XIX, sipas mendimit tonë qëndron në faktin se me këtë vepër, në mënyrë më të ngulitshme, zuri fill përpjekja programore e Rilindjes për futjen e gjuhës shqipe në shërbime të fesë islame në xhami dhe gjetkë, përkatësisht thellimi i punës në drejtim të shqiptarizimit sa më të plotë të xhamisë, kërkesa këto që nisën qysh në periudhën e pararilindjes, së paku nga fundi i shek. XVII. Rëndësia tjetër e veprës është për albanistikën si dije dhe pikërisht për gjuhësinë shqiptare”⁵¹.

Tahir efendi Boshnjaku, si mendimtar i filleve të Rilindjes Kombëtare, gjatë punës së tij arsimore dhe kulturore shkroi edhe vepra të tjera laike dhe fetare, të cilat, për fat të keq, u zhdukën gjatë fushatave antishqiptare që ndërmori Perandoria Osmane. Njëra prej tyre i kushtohet zakonisht të gjakmarrjes të shqiptarët.⁵²

Tahir efendi Lluka, pasi kreu Medresenë e Madhe në Gjakovë, vazhdoi studimet në Fakultetin Teologjik “Fatih” në Stamboll, ku, pasi mbaroi me sukses studimet, u bë aty profesor rreth viteve 70 të shek. XIX., në kohën kur ishte rektor i Universitetit të Stambollit Hoxha Tahsini. Aty u mor me veprimtari kulturore kombëtare, duke pasur lidhje me rilindësit tanë, ndër ta edhe me Jani Vreton.⁵³ Ai e njoftoi Vreton për veprën “Emni Vehbije”⁵⁴. Si duket pas komprometimit politik në

48 Op. cit. 382.

49 Op. cit. 383. H. Koliqi, *Hist. e ars...*, f. 137-138.

50 J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f. 142.

51 M. Pirraku, *Kult. komb. shqip...*, f. 384.

52 Cf. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 136; M. Pirraku, *Kult. komb. shqip...*, f. 379.

53 M. Pirraku, *Kult. komb. shqipt...*, f. 393; Cf. J. Vreto, *Vepra të zgjedhura*, f. 263; P. Krasniqi, *Aspekte kul. hist. të Gjakovës*, f. 101.

54 Op. cit. f. 377, 379.

sytë e pushtetit osman të Hoxha Tahsinit për shkak të veprimtarisë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, u komprometua edhe Tahir efendi Llu-ka, i cili u tërhoq në Gjakovë.⁵⁵ Më 1873 shkroi mevludin në gjuhën shqipe dhe vargje të tjera me karakter didaktik.⁵⁶

Numri i madh i intelektualëve shtroi nevojën për përhapjen e një numri sa më të madh institucionesh arsimore, shkencore dhe kulturore në Gjakovë. Përmendet një bibliotekë, e cila u themelua më 1733 në Xhaminë e Hadumit.⁵⁷ Por tash për tash nuk jemi në gjendje të pohojmë se a bëhet fjalë për ndonjë bibliotekë të re pranë asaj që themeloi Hadim aga më 1594⁵⁸, apo për zgjerimin ose meremetimin e saj. Prandaj, Sami Frashëri, duke bërë fjalë për Gjakovën, ndër të tjera, shkruante: "Nga gjiri i këtij shehri gjithmonë ka pas dijetarë të dëgjuar dhe muderriza, gjithashtu ka shumë edhe të atillë që kanë ardhur në Der-i seade (Stamboll-MR) për të studiuar."⁵⁹

Myderrizët e medreseve të Gjakovës ishin halë në sy për autoritetet osmane edhe në dhjetëvjetëshin e parë të shek. XX. Ata nuk u mashtruan nga propaganda e pushtuesit, e cila, nga njëra anë e paraqiste sulltanin si "Hiye të Perënis, e veqil të Pejgamberit", i cili iu prem-tonte shqiptarëve se "un s'kam uzdajë e çpnesë veç në ju, shpejt do t'ju gëzoj"!; ndërsa nga ana tjetër, nuk ua njihte shqiptarëve as një nga ato të drejta kombëtare e shoqërore që ua kishte njohur popujve të tjerë fqinj. Prandaj, dërgoi Shemsi pashën për të vrarë e djegur të

55 Op. cit. f. 393.

56 Ibid.

"Kjo Shqipni ka met krejt pa dit xho n'xhahili
erdhi vakti me dal n'mejdan kjo Shqipni
mu madhnie ky temel u marue për Shqipni
n'selamet për me dal kjo fukara ko ka qillue. (P. Krasniqi, Aspekte, f. 102-103).

57 Cf. M. Yvejsi, *Kështjellat e gjakut tonë*, f. 11.

58 Cf. N. Krasniqi, *Roli i fisnikërisë...*, f. 216; J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars. shqip...*, f. 126.

59 Feti Mehdiu, *Kosova në "Kamus al 'alam" të Sami Frashërit*, "Kosova" Prishtinë, 1974, nr. 3., f. 478. Konsulli rus i Prizrenit Jastrebovi shkruante se në Gjakovë kishte "20 shkolla me të ardhura, dy medrese fetare. Në këto medrese mësojnë shumë nga Kolashini dhe vendet tjera. Profesorët shquhen për dituri, ndërsa Gjakova kryesisht konsiderohet fidanishte e muslimanizmit të vërtetë". I.S. Jastrebov, *Stara Serbija i Albanija*, Spomenik XLI SKA, Beograd, 1904, st. 2; Cf. J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...* f. 153; I.S. Jastrebov, *Stara Srbija*, Novi svet, Priština, 1995, st. 178.

gjithë ata që i mbronin me armë të drejtat e tyre kombëtare. Ai, sipas gazetës “Drita” të Sofjes, internoi në Anadoll edhe myderrizë të Gjakovës.⁶⁰ Në një artikull tjetër të redaksisë së “Drita”- s lexojmë edhe këtë: “Guverna e Osmanllive asht në gajle të madhe, sepse s’mundet me i pshtue shqyptarët as me hoxhë fanatikë të verbumun, as me topa e me ushtri. Jildiz-Qoshku menohet si e si me i bo shqyptarët myslimanë qi ta lanë dashuninë që mbajnë për gjuhën e për kombësinë e tyre; ajo, “Turkia Dosë”, dishiron qi shqyptarët ta harojn’ istorin’ e tyre e kështu tash për tash me ja u pi gjakun me vergji të randa e mas pak kohë t’i ketë gati për n’Anadoll”. Më tutje vazhdon: “I nerushmi myfti i Gjakovës me disa zotnija t’jerë, qi me trathiti i pat çu guverna syrgjyn n’Anadoll, në Kastamoni kanë mbri shëndosh’ e mirë në Gjakovë. Por sikundra shkrojshin gazetata e huëja, Turkia i lshoi për me shku në Shqypni këta të parë të Gjakovës, se Malësia e Gjakovës e kishin shtrëngu fort governnën (qeverinë-MR) edhe gjinja e Kastamonit i bonte ner të math myfti shqiptarit; pra Sulltani u tremp edhe i lshoi ata qi ishin në Kastamoni. Por Riza begu e shumë t’jerë janë hala syrgjyn n’Anadoll, edhe asht frigë se mos i helmojn ose i vrasin”.⁶¹

Myderrizi i Gjakovës, Jusuf Ibrahim efendiu shprehte, në gazetën “Liria” të Selanikut, më 1909, entuziazmin që kishte përfshi qytetin e tij për mësimin në gjuhën shqipe.⁶²

Në Kuvendin e Junikut (21-25 maj 1912), në të cilin u miratua programi politik i Kryengritjes së Përgjithshme kundër sundimit osman, ku përfshihej edhe kërkesa për caktimin e gjuhës shqipe me alfabetin kombëtar si gjuhë zyrtare në administratë dhe në shkolla, bashkë me përfaqësuesit e tjerë nga Gjakova si Riza beu, Ahmet beu, Murat Vokshi, Hysni Curri dhe Hasan aga i Isa Zekës, mori pjesë edhe myderrizi Hasan efendi Shllaku.⁶³ Hasan efendiu bashkë me krerët e tjerë

60 “Drita”, Sofje, 1905, 15 nëntor, nr. 70; Autori: M. Xhakova, *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi)*, Vëllimi I 1879-1908, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1971, f. 135-136.

61 “Drita”, Sofje, 1906, 1 mars, nr. 74; Mend. pol. e shoq. i Ril. Komb. Vëll. I, f. 196.

62 “Jakovë, 3 korrik, Myderris i Jakovës, Jusuf Ibrahim efendi shkruan: “Dëshir e mësimit shqip dita për ditë po përparon...”. “Lirija”, 11.VII.1909; Jashar Rexhepagiq, *Shkollat shqipe veçanërisht në Kosovë gjatë viteve 1908-1910 (sipas burimeve të reja)*, “Kosova”, Enti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1974, nr. 3., f. 199.

63 N. A. Emeljanov, *Nënkonsullata e Perandorisë së Rusisë në Prizren, Shkëlqje-*

të kryengritjes hyri në Prishtinë më 22 korrik 1912.⁶⁴

Sipas burimeve serbe, në Kuvendin e Junikut merrnin pjesë edhe myderrizë të tjerë nga Medreseja e Madhe dhe Medreseja e Vogël.⁶⁵

Shkolla e vjetër shqipe, e hapur dhe e financuar pjesërisht nga Austro-Hungaria, e vazhdoi punën deri në fillim të shek. XX.⁶⁶ Pos mësimi shqip, në fillim të këtij shekulli, në Gjakovë u përhapën edhe librat e gazetat shqipe.⁶⁷ Falë angazhimit të intelektualëve shqiptarë në Stamboll ajo e vazhdoi punën edhe më tutje. Mësues në këtë shkollë ishin Mihill Kurti, Pashko Logoreci, Ndue Bytyçi dhe Engjëll Ndoca.⁶⁸

Revolucioni xhon turk dhe premtimet e qeveritarëve të rinj për më shumë të drejta kombëtare i dhanë hov lëvizjes për arsimimin në gjuhën shqipe si rrugë e vetme për të dalë nga errësira shekullore që kishte përfshirë vendin, pos tjerash, edhe për shkak të pamundësisë së shkollimit në gjuhën shqipe. Në këtë drejtim u dallua edhe Gjakova. Në gazetën “Liria” të Selanikut, në një korrespondencë të 3 dhjetorit 1908 nga Shkupi me titull “Letrë pi Kosove,” pos tjerash, lexojmë: “Ndër të gjitha gjytetet e Kosovës ma të kënaqun jemi për Gjakovën për kah ana e shqyptarizmit. Prej kti vendi marrim lajme të mira, ku na diftojn qi një pjes e madhe e vendalive kanë msue me knu e me shkruie gjuhën e vet; e kët pun e patnë fidthue (filluar-MR) qysh se përpara lirijes (vitit 1908 – MR). Gjakovasit përpiqen për me çil një msonjtore shqyp, e kemi uzdaj (shpresë-MR) qi ky mendim ka me u pëlqye prej krejt gjytetit e me u

sisë së Tij, M.N. Girs, ambasador i Perandorisë në Konstantinopojë, Prizren, 15/28 maj 1912, *Dokumente ruse për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare më 1912*, Hulumtuan, përzgjedhën dhe përgatitën Prof. Dr. Muhamet Shatri dhe Prof. Dr. Ramiz Abdyli. Instituti i Historisë - Prishtinë, Prishtinë, 2006, f. 97.

64 N. Llobaçev, Konsullata e Perandorisë së Rusisë në Mitrovicë, Departamentit të Parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Sankt Petersburg, Mitrovicë, 12/25 korrik 1912. *Dok. ruse mbi LKSH*, f. 174.

65 Konsulli serb M. Millojeviqi i dërgoi dy raporte nga Prishtina në Beograd lidhur me Kuvendin e Junikut: më 2 qershor 1912, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Serbisë dhe, më 5 qershor 1912, drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Serbisë Millovan Mill-ovanoviqit. Dokumenti o spoljnoy politici Kraljevine Srbije 1903-1914. Knj. V. Sv. I. Bjeograd, 1984, s. 679, 724.

66 J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars. shqip...*, f. 189-190; Idem, *Zhvill. i arësimit...*, f. 167; A. Hadri, *Gjakova deri më 1941*, f. 393.

67 Cf. H. Myzyri, *Shkollat e para komb. Shqipe...*, f. 193.

68 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 234; Idem, *Shkoll. dhe ars...*, f. 216.

krye për të madhe dobi e lulzim të kombit ton e sidomos ktyne viseve të Kosovës qi, sikur thash sypri, qi sot jan për t'u kjamun me lot gjakut. Shpnesojm, pra, qi Gjakova ka me ken shembull edhe i tjerave qytete në Gegni e sidomos në Kosovë, ku shqyptari asht fort lerk e qi në kioftë qi shqyptarët e vërtet s'përpiqen me gjith fuqin qi kan për këto ana, jemi në rrezik të math, se anmiqt na kan rrethu gjithkah, ku me tradhtime t'tyne me na ba me ia siedh shpinen kombit tonë..."⁶⁹

Po në këtë gazetë, një vit më vonë, lexojmë edhe këtë: "Deshir e mësimit shqip dita për ditë po përparon. Numri i atyre që dinin të këndojnë shqip s'isht më tepër se 300 kur sot janë më shumë se 1000 veta që këndojnë dhe shkrojnë gjuhën tënë. Sikundrë q'është bërë dhe në qytetet tjera ashtu dhe në Jakovë do të çelet një klub shqip."⁷⁰ Po këtë atmosferë entuziazmi na e sjellë edhe gazeta e Sofjes "Shqypeja e Shqypënis" e 15 korrikut 1909, e cila shkruante se në Gjakovë filluan ta mësojnë gjuhën shqipe "i madh e i vogël", të cilët përpiqeshin "me gjith zembër për shëndritjen dhe qytetnimin e Shqypënis"⁷¹.

Gazeta "Lirija", më 1909, na sjellë një informatë për dërgimin e shtatë nxënësve në normalen e Elbasanit me ndihmën e klubit të Shkupit. Ndër ta ishte Hamdi Ibrahim Jakova.⁷² Po kjo gazetë lajmëronte, më 6 shkurt 1910, se në normalen e Elbasanit shkoi Rexhep Mehmed Jakova.⁷³ Një muaj më vonë, sipas gazetës së përmendur, shkuan në normalen e Elbasanit Haki, Ibrahim dhe Arsllan Jakova,⁷⁴ ndërsa në mars të po këtij viti shkuan edhe Arsllani nga Jakova, Hajredini nga Jakova dhe Ramisi nga Jakova.⁷⁵

69 "Lirija," Selanik, 13 dhjetor 1908; *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Përmbledhje artikujsh nga shtypi)*. Vëllimi II 1908 – 1910, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1976, f. 294.

70 "Lirija," 11.VII. 1909; J. Rexhepagiq, *Shkollat shqipe...*, f. 199; Prof. dr. Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë, 1996, f. 110. Pas Kongresit të Dibërës, klubi shqiptar i Shkupit mendonte të krijonte pranë klubeve shqiptare të Vilajetit të Kosovës kurse të gjuhës shqipe dhe të hapte shkolla fillore në gjuhën shqipe. Në këtë kuadër duhej të hapej një në Gjakovë. H. Myzyri, *Ars. komb. shqiptar...* f. 186.

71 H. Myzyri, *Ars.komb. shqiptar...* f. 110.

72 "Lirija," 28 vjesht' e tretë 1909; J. Rexhepagiq, *Shkollat shqipe...*, f. 201.

73 "Lirija," 6. II. 1910; J. Rexhepagiq, *Shkollat shqipe...*, f. 201.

74 "Lirija," 20. III. 1910; J. Rexhepagiq, *Shkollat shqipe...*, f.202.

75 Bashkim' i Kombit," 25. III. 1910; J. Rexhepagiq, *Shkollat shqipe...*, f. 202.

Të përmendim, me këtë rast se Bajram Curri i kushtoi kujdes të veçantë përdorimit të gjuhës shqipe në shkollë para revolucionit të Turqve të Rinj. Në një raport të konsullatës austro-hungareze në Shkup, ndër të tjera, lexojmë: “Inisjatorja e saj (e kërkesës për përdorimin e gjuhës shqipe në shkollë dhe në letërsi – MR) është “Shoqëria për lirinë e Shqipërisë” dhe sidomos degët e saj në Selanik dhe Manastir, të cilat me shumë energji dhe shumë zotësi kanë filluar pushtimin e Kosovës për idenë kombëtare...Në këtë mënyrë të dërguarit e “Shoqërisë,” të cilët qysh nga fillimi i këtij viti (1906-MR) po kalojnë nëpër vilajetet, korrën suksese të habitshme. Në radhë të parë, në Gjakovë, ku u formua një degë e “Shoqërisë,” e cila ka shumë anëtarë, ndër ata edhe bejlerët më me rëndësi. Në të hyri edhe Bajram Curri që u kthye në Gjakovë, të cilin qeveria turke zakonisht e mban në Shkup.”⁷⁶ Më vonë Bajram Curri e vazhdoi veprimtarinë për përhapjen e arsimit shqip. Sipas shtypit të kohës atdhetari i shquar orvatej “me gjithë zember për me pa amën Shqypëni një or ma shpejt të shëndritur e të qytetnuet.”⁷⁷

Sipas kujtimeve të Sali Morinës, njërit nga pishtarët e parë të arsimit shqip në Gjakovë gjatë Luftës së Parë Botërore, që në vitet 1905-1906, një grup arsimdashësish si Osman Nikoliqi, Riza Thaçi, Haxhi Tahiri e të tjerë organizuan nën masa të rrepta ndjekjeje të pushtetit osman kurse, në të cilat mësohej gjuha shqipe fshehurazi. Njeri nga vijuesit e këtyre kurseve ishte edhe Sulejman Ibra nga fshati Ahmataj i Malësisë së Gjakovës, i cili ka dërguar, më 1909 - 1910, edhe disa artikuj në Sofje mbi përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe në Gjakovë dhe në Malësinë e saj.⁷⁸

Bajram Curri bëri përpjekje për hapjen e shkollës shqipe në Gjakovë dhe në fshatrat përreth qysh më 1911. Gazeta “Shkupi”, më 1911, në artikullin “Bajram be Curri dhe shkollat shqipe”, ndër të tjera, shkruante:”Në saje të ndihmës morale të Bajram-begut në Gjakovë, mendojmë se brenda një kohe të shkurtë - me leje të shtetit - do të hapim

76 Raport i konsullatës austro-hungareze, Shkup 1 Maj 1906. Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit, Universiteti i Tiranës, Instituti i Historisë-Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë, Tiranë, 1972, f. 296-297.

77 “Shqypeja e Shqypënis,” Sofje, 15 korrik 1909; H. Myzyri, Ars. komb. shqiptar... f. 110; H. Koliqi, Hist. e ars... , f. 336-337.

78 Selim Matoshi, *Një shekull dritë - Arsimit në Tropojë në shek. XX-të*, Tiranë, 2004, f. 30.

shkollat shqipe si në Gjakovë, ashtu edhe në fshatra të Gjakovës. Ja, ditë fatlume për popull...”⁷⁹

Të theksojmë se në përhapjen e librit dhe të shtypit në gjuhën shqipe, të ndaluar rreptësisht nga pushteti osman, një meritë të veçantë kishte Teqeja e Bektashinjve në Gjakovë. Shumica e pjesëtarëve të tarikatit të saj Osman Nikoliqi, Ismail efendi Ibrani, Sadik Zajmi, Ali Zajmi, Mustafë Këpuska, Niman Ferizi, familja Tërbeshi etj. i shpërndanin librat shqipe, të botuara në Bukuresht dhe në kolonitë e tjera shqiptare, të cilat i sillte deri në Shkup Osman Nikoliqi. Nga Shkupi i tërhiqte në Gjakovë Idriz Nivokazi⁸⁰. Ato ruheshin deri më 1906 në familjen Zajmi, deri kur u zbulua kjo bazë dhe u konfiskuan kontingjentet të mëdha librash shumë interesante, madje, edhe të tjera në gjuhë të huaja, me ç’rast u burgos Ali Zajmi, i cili u torturua keq, por që shpëtoi, falë protestave të rrepta të krerëve të Malësisë, që i kërcënuan me armë autoritetet qeveritare osmane. Pas kësaj depoja e librave shqipe kaloi te familja Terbeshi. Për ta kursyer familjen Zajmi nga torturat e mëtejshme, edhe mbledhjet që mbaheshin për organizimin e shpërndarjes së librit shqip në viset e tjera të Kosovës, vazhduan të organizoheshin, më vonë, në shtëpinë e Taib Bakisë, ku banonte Haxhi Adem Babai, kreu i Teqesë së Bektashinjve⁸¹.

Ndjekjet dhe torturat ndaj atdhetarëve shqiptarë, në raste krijash dhe kryengritjesh antiosmane merrnin përmasa të tmerrshme. Në një anë ata varën asokohe në Gjakovë Shaban Binakun, ndërsa nga ana tjetër masakruan në burg bashkëpunëtorin e ngushtë të Bajram Currit, telegrafistin Idriz Nivokazin⁸².

Në vitet 1910-1912 Ali Zajmi ishte korrespondent i gazetave “Shqipëtar”, “Drita”, “Shkupi”, dhe “Shkumbi”, në të cilat botonte me pseudonimin Besniku, pos shkrimeve patriotike mbi ngjarjet e kohës, edhe artikuj kushtuar, kryesisht, shkronjave dhe librave shqipe. Kështu,

79 Gazeta Shkupi nr. 5, f. 2, e vitit 1911. Cituar sipas J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësim-it...*, f. 233; Idem, *Shkoll. dhe ars...* f. 215.

80 Bujar Rexha, *Baba Qazimi-pishtar i arësimit shqip*, “Rilindja”, Prishtinë, 1971, 7 nëntor; Idem, *Atentat kundër ministrit turk*, “Rilindja”, Prishtinë, 1971, 13 nëntor.

81 Shaban Zajmi, *Ngjarje kohe-Rrjedha jete (Ditar. Dorëshkrim)*, Arkivi i familjës Zajmi në Gjakovë.

82 Ibid. Bajram Curri, me lot në sy, u betua publikisht para trupit të masakruar të bashkëpunëtorit të tij se do të hakmerrej pa mëshirë kundër pushtuesëve osmanë. Ibid.

bie fjala, ai lajmëronte, pos tjerash, se “Vendimi i Shehislamit (Kryefetarit të Perandorisë-MR) për përdorimin e shkollave arabishte për gjuhën shqipe ka shkaktuar në Shqipëri një zemërim shumë më të madh se pandeheshe”⁸³. Në shkrimin “Cilët janë fajtorët e vërtetë që s’kemi libra shkollare?” autori ankohet se të gjitha këto shoqëri që ekzistojnë jashtë vendit nuk po janë në gjendje t’i plotësojnë të gjitha nevojat për libra shkollorë për shkak të “mos përkujdesuri që tregojnë (prijësit e këtyre shoqërive-MR) për nevojat e kombit dhe për dembellëkun e tyre”. Ai kërkonte “që këta qeveritarë që e shohin veten e tyre në pasqyrë me artikullin tonë, ose të zënë të punojnë ashtu si e kërkon interes’ i kombit Shqipëtar dhe qëllimi i shoqërisë që qeverisin ose të lënë vendin që kanë të tjerëve që të punojnë...”, sepse “Dit për dit po marrim letra nga të gjithë anët e Shqipërisë me anën e të së cilave na kërkojnë libra dhe ne na copëtohet zemra kur u përgjigjemi dhe u themi se nuk u kemi”⁸⁴. Po në këtë numër hasim edhe në shkrime të tjera të Ali Zajmit mbi ngjarje të kohës, sidomos të atmosferës që mbretëronte midis kryengritësve që ishin strehuar në Mal të Zi dhe të gjendjes së nderë në Gjakovë dhe në Malësinë e saj. Por, do të ndalemi shumë shkurt në shkrimin “Libra mallëkim’ i shkronjavet Shqip”, i cili “përmbledh veprat dhe qëllimin për të cilët shorti priftëror i Patriarqisë ka mallëkuarë shkronjatë Shqipe, dhe tregon gjer’ e kthielltë mënyrën që kanë përdorur dhe po përdorin meshëtarët’ e kishësë Patriarqika kundër përparimit të shkronjavet dhe gjuhësë Shqipe”. Sipas tij “Në këtë libër merrenë vesh kthielltë gjithë intrigat dhe paudhësitë me të cilatë doninë dhe duanë të pengojnë përparimin e gjuhësë Shqipe punëtorët e kishesë Patriarqike”. Ai përfundonte se “Kjo libër është një mësim për të përdorur ndër ata që s’dinë ç’është feja, dhe një përdurje e fortë për të mburuarë nga intrigandët që përdorinë fenë si gogol kundër të paditurët. Prandaj këtë libër e dorëzojmë në gjithë miqt’ e së vërtetësë dhe së drejtësë”⁸⁵

83 “Shqipëtar”, Stamboll, 1911, 14 kallnor.

84 “Drita”, Manastir, 1911, 14 prill.

85 Ibid. Në artikullin “Shkollat po hapen!... A. Zajmi shpreh kënaqësinë për dëshkrimin e përpjekjeve të qeveritarëve osmanë për t’i bindur nxënësit shqiptarë për të përdorur abetare shqipe me shkronja arabe. “Shkumbi”, Pera, E enjte 29 Shenendreit, Mot’ i III No 10-69.

Në shkrimin “Qitabi Gjakut” hudh poshtë shpifjet serbe mbi vrasjen e 200 serbëve ne Vilajetin e Kosovës. “Shkupi”, Shkup, 1912, 21 mars.

Në shkurt të vitit 1912, don Pashk Krasniqi, famullitar i Ferizajit, kërkoi nga përfaqësuesi austro-hungarez në Beograd hapjen e një gjimnazi katolik në Gjakovë.⁸⁶

Bajram Daklani dhe Zeqir Halili, në mars 1912, ia prenë rrugën Haxhi Adil beut, ministrit të brëndshëm turk të Ura e Fshajit dhe i kërkuan hapjen e shkollave shqipe dhe përdorimin e alfabetit latin në to.⁸⁷ Mirëpo, okupimi i qytetit nga forcat serbo-malazeze më 1912 pengoi çfarëdo orvatjeje për hapjen e tyre.⁸⁸

Lufta e Parë Botërore krijoi kushte të favorshme për ngritjen e shkollave të reja në Gjakovë dhe në vise të tjera të Kosovës. Pas depërtimit të ushtrisë austro-hungareze drejt jugut, ushtritë serbo-malazeze u detyruan ta lëshojnë Gjakovën dhe një pjesë të Rrafshit të Dukagjinit. Kësisoj, me nismën e Bajram Currit, u hapën në Gjakovë shkollat shqipe para arritjes së ushtrisë austro-hungareze.⁸⁹ Sipas njërit nga mësuesit e parë të kësaj shkolle, Qazim Bakallit, një grup mësuesish, kryesisht, gjakovarë, shumica bashkëpunëtorë të Bajram Currit, u mblodhën në shtëpinë e Niman Ferizit dhe vendosën ta shfrytëzojnë rastin e përshtatshëm për ta hapur shkollën shqipe në Gjakovë. Aty u miratua vendimi edhe për themelimin e Bashkisë së vendit me nëpunës shqiptarë

86 Cf. Masar Rizvanolli, *Dëshmi për nevojën e zgjerimit të rrjetit shkollor në Vila-jetin e Kosovës më 1912*, "Gjurmime albanologjike – Seria e shkencave historike", Prishtinë, 1995, nr. 23 – 1993, f. 125-138.

87 S. Matoshi, *Një shekull dritë...*, f. 31.

Njëra nga pikat e memorandumit të miratur në "Kuvendin e katër bajraqeve" të Malësisë së Gjakovës, më prill 1912, kërkonte, pos tjerash, hapjen e shkollës shqipe dhe qarkullimin e lirë të librit shqip me alfabetin latin. Op. cit. f. 32; Cf. J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f. 223-24.

88 Gjenerali Veshoviq mendonte "që të mos lejohet kurrsesi hapja e kësaj shkolle (në Pejë-MR), sepse pastaj po këtë do të kërkojnë edhe katolikët në Gjakovë e rrethinë ku ekzistojnë 650 shtëpi." Cituar sipas J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 234; Cf. J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f. 217.

89 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 259; Prof. Dr. sc. Aabdylaziz Veseli, *Shkollat dhe arsimit shqip në Prefekturën e Prizrenit gjatë periudhës 1941 – 1944 III*, Biblioteka:Historia e pedagogjisë shqiptare, Gjilan, 2003, f. 240; A. Hadri, *Gjakova deri më 1941*, f. 419.

Ardhja e ushtrisë austro-hungareze dhjetë ditë pas hapjes së shkollave shqipe në Gjakovë, të cilës iu bashkua edhe ushtria bullgare, e cila qendroi bashkë me aleatët e saj nga Vjena në gjashtë muajt e parë nuk mundën ta pengojnë punën e këtyre shkollave ndaj të cilave kishin qendrim të rezervuar. J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f.229.

dhe me administratë në gjuhën shqipe. Shkolla menjëherë ia filloi punës në ndërtesën e Mejtepit Ruzhdije. Mësuesit punonin pa pagesë, pasi që qëllim të vetëm kishin shkollimin sa më të shpejt të të rinjve në gjuhën shqipe,⁹⁰ përgatitjen e tyre për të punuar në administratën e vendit dhe për tu aftësuar të ndjekin shkollimin e mëtejshëm.⁹¹

Shkolla fillore e Gjakovës ishte e ngarkuar me më shumë lëndë mësimore se sa shkollat e tjera të të njëjtit rang. Kjo bëhej për shkak të mungesës së shkollave të mesme, të cilat do të siguronin kuadro për administratën e re në gjuhën shqipe. Për këtë arsye kjo shkollë ishte gjashtë klasëshe.⁹²

Kjo shkollë punonte sipas programit sintetik të Austrisë. Qëllim kryesor kishte edukimin mendor e fetar të nxënësve. Prandaj nxënësit ishin të ngarkuar me shumë orë në javë. Tekstet që përdorshin në këtë periudhë ishin të botuara në Vjenë.⁹³

Lënda kryesore në këtë shkollë ishte gjuha shqipe. Këtë e dëshmojnë detyrat që merrnin nxënësit nga arsimtarët për mbledhjen e këngëve popullore, gjëgjëzave, anekdotave, përrallave etj.⁹⁴ Pos kësaj mësoheshin aritmetika, gjeometria, historia, gjeografia, histori natyre, fizika, lëndët e shkathësive si bukurshkrimi, kënga, gjimnastika; mësohej “dija gjytetnore”, mësimi i fesë dhe kurani.⁹⁵

Mësuesit e parë të kësaj shkolle ishin ata që morën nismën për hapjen e saj: Niman Ferizi, Sali Morina, Ferid Imami, Ibrahim Fehmiu, Qazim Bakalli, Ibrahim Kolçi, Mon Osa, Isuf Puka, Murat Gjakova (Muhaxhiri), Engjëll Ndoca nga Shkodra, Latif Shaqiri, Beqir Quka (Pozhegu) etj.⁹⁶

90 Jusuf Buxhovi, *Shkëndi e arsimit shqip në Kosovë*, “Rilindja,” Prishtinë, 1970, 7 nëntor; J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe arës...*, f. 229.

91 Cf. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260; Dr. Aabdulla R. Vokri, *Ibrahim Kolçi mësues e patriot*, “Rilindja,” Prishtinë, 1993, f. 32.

92 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f.260; Idem, *Shkoll. dhe ars...*, f. 229; A. Vokri, I. Kolçi..., f. 32.

93 A. Vokri, I. Kolçi..., f.32.

94 Ibid.

95 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260; Idem, *Shkoll. dhe ars. ...*, f. 230; A. Vokri, I. Kolçi..., f. 32.

96 J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. Shqip*; Bujar Hoxha, *55 vjetori i shkollës së parë shqipe në Gjakovë të Kosovës*, “Mësuesi,” Tiranë, 1970; J. Rexhepagiq, *Shkoll. dhe ars...*, f.

Shkolla e parë shqipe në Gjakovë “Skënderbeg” ishte nën kujdesin e klubit patriotik “Besa kombjare,” i cili zhvillonte në Gjakovë dhe në qytete të tjera të Kosovës një veprimtari të dendur politike patriotike. Drejtor i parë i shkollës u caktua Sali Morina.⁹⁷

Më vonë, në Gjakovë u themeluan edhe dy shkolla shqipe katërklasëshe me 500 nxënës. Drejtorë të këtyre shkollave ishin mësuesit nga Zara: Tomo (Ivo) Maroviq, Zef Duka dhe, në fund, mësuesi Peroviq.⁹⁸

Në Gjakovë u themelua një shkollë e veçantë për vajza, në të cilën punuan mësueset Dominika Ndoca, Jozefa Ndoca dhe Eminja e Haxhi Sheh Dulës.⁹⁹

Krahas klasave për nxënës të rregullt, në Gjakovë u hap edhe një kurs për të rritur analfabetë, në të cilin, më 1918, i vijonin mësimet, “150 persona të rritur moshe prej 18-40 vjeçare.”¹⁰⁰

Mësuesit e shkollave shqipe të qytetit të Gjakovës ndihmuan shumë në zgjerimin e rrejtit shkollor nëpër fshatra dhe qendra të tjera të Kosovës. Kështu, bie fjala, po më 1915, u hap në Pejë Shkolla Fillore “Skënderbeu” drejtor i të cilës ishte Murat Gjakova (Muhaxhiri),¹⁰¹ të cilit iu bashkua, më vonë, Ibrahim Kolçi.¹⁰² Ibrahim Kolçi, para se të kalojë me shërbim në Pejë, e mori një vërtetim nga trupi mësimit

229-30; A. Veseli, *Shkollat dhe ars. shqip...*, f. 240; A. Vokri, I. Kolçi... f. 32.

97 B. Hoxha, *55 vjetori i shkoll. së parë*; A. Veseli, *Shkollat dhe ars. shqip...*, f. 240; Cf. A. Vokri, I. Kolçi..., f. 28.

98 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260; Idem, *Shkoll. dhe ars...*, f. 230.

99 “Cetinske novine”, Cetinë, 1918, nr. 161, sipas J. Rexhepagiqit, *Shkoll. dhe ars...*, f. 230.

Bujar Hoxha flet për hapjen e një klase me 30 vajza qysh në ditën e parë të mësimet të shkollës. B. Hoxha, *55 vjetori i shkoll. së parë*; Cf. A. Veseli, *Shkoll. dhe ars. shqip...*, f. 240.

Jusuf Buxhovi flet për regjistrimin e 15 vajzave, “të cilat mësonin në një paralele të veçantë (njëra ndër këto nxënëse të para ishte edhe Sheribone Koshi, e cila jeton në Gjakovë).” J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. Shqip*.

100 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260; Idem, *Shkoll. dhe ars...*, f. 230; A. Veseli, *Shkoll. dhe ars. shqip...*, f. 240. Sipas B. Hoxhës “qysh në vitin e parë të çeljes së shkollës plotore për fëmijë u hap edhe shkolla shqipe për të rritur. U regjistruan rreth 300 nxënës. Ata i zhvillonin mësimet në të njëjtin lokal dhe nga të njëjtit mësues.” B. Hoxha, *55 vjetori...*

101 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260, 263.

102 J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. shqip...*; Cf. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 260.

i Gjakovës, të cilin e vërtetoi shoqëria “Besa Kombijare” e Gjakovës, vërtetim që iu lëshohej të gjithë atyre mësimdhënësve, të cilët nuk ishin shkolluar në gjuhën shqipe, por që ishin të aftë të mbanin mësim në shkollat shqipe. Pas këtij formaliteti, drejtori i arsimit të Gjakovës i drejtohet inspektorit të arsimit në Pejë:”Ju njoftojmë zotërisë suaj se në vend të mësuesit Ibrahim Fehmiu, po ua dërgojmë mësuesin Ibrahim Kolçin. Me nderime, nga drejtori i arsimit Sadiku”.¹⁰³

Në shkollën tjetër “Haxhi Zeka” të Pejës ishte mësues Ali Hajdar Berisha (Haxhishehdula) nga Gjakova.¹⁰⁴

Në Vushtrri shkollën shqipe e drejtonte, Abdullah Hadri; në Çermjan Muharrem Domi; në Drenoc të Vokshit Ibrahim Fehmiu;¹⁰⁵ në Irzniq Latif Shaqiri.¹⁰⁶

Mësuesit dhe arsimtarët e klasave të larta të shkollave shqipe të Gjakovës kishin kryer, kryesisht, Shkollën Normale të Beratit (Qazim Bakalli), apo idadijen (gjimnazin turk) e Shkupit (Latif Shaqiri, Ibrahim Kolçi, Beqir Pozhegu, Muharrem Domi).¹⁰⁷ Disa prej tyre kishin njëfarë përvoja pedagogjike si Sali Morina, Niman Ferizi, Ferid Imami dhe Qazim Bakalli, të cilët, gjatë vitit shkollor 1913/1914, kishin shërbyer si mësues të shqipes në Berat nën drejtimin e patriotit Babë Dudë Karbunarës.¹⁰⁸ Ibrahim Kolçi e kishte filluar karrierën e tij në Kala të Dodës gjatë vitit shkollor 1911/1912 për ta vazhduar në Krumë gjatë vitit shkollor 1914/1915. Pas legalizimit të shkollave shqipe në Kosovë, me ndihmën e Bajram Currit, ai bashkë me një grup mësuesish kosovarë kthehet në vendlindje.¹⁰⁹

Disa të tjerë, 17 prej tyre, kishin kryer kursin pedagogjik dymujor në Pejë gjatë viteve 1916 dhe 1917.¹¹⁰

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore më 1918 u mbyllën të gjitha shkollat shqipe në Kosovë. Gati të gjithë mësuesit patriotë gjak-

103 A. Vokri, I. Kolçi..., f. 28; Cf. Arkivi i Kosovës, Sig. XXXIV, K. 1-4, 1916.

104 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 263; Idem, *Shkoll. dhe ars...*, f. 231; A. Vokri, I. Koçi..., f. 29.

105 Op. cit. f. 260.

106 Ibid.

107 Ibid. J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. shqip.*

108 B. Hoxha, *55 vjetori...*

109 A. Vokri, I. Kolçi... f. 23, 28; Cf. J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 262.

110 J. Rexhepagiq, *Zhvill. i arësimit...*, f. 262; Cf. J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. Shqip;* A. Vokri, I. Kolçi..., f. 34.

ovarë kaluan në Malësi ku, më 17 tetor 1922, themeluan shkollën e parë shqipe në lagjen Dojan të fshatit Bunjaj, e cila ishte nën përkujdesjen e Bajram Currit dhe të shokëve të tij. Shkolla me internatin “Kosova,” në fillim në Kolgecaj, e, më vonë, në Krumë u bë çerdhe e të rinjve kosovarë, të cilët, duke rrezikuar jetën, kalonin kufirin për tu shkolluar në gjuhën amtare.¹¹¹ Ata hasën në një atmosferë të ngrohtë prindërore, të krijuar nga mësuesit në shkollë dhe nga malësorët bujarë jashtë saj. Për të përballuar shpenzimet jetësore, shteti shqiptar, me gjithë mjetet e kufizuara buxhetore, caktoi për nxënësit kosovarë një numër bursash, që kurrë nuk ishin të mjaftueshme për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të tyre. Në një raport të Prefekturës “Kosova”, dërguar Ministrisë së Arsimit në gusht 1923, ndër të tjera, lexojmë: “Kjo Prefekturë ka ngelë në një pozicion tepër të vështirë para drejtimeve (kërkesave-MR), që janë tue ju ba prej djemve të vegjël të Kosovës, që tue lanë pllang e shtëpi, gjithnjë po vijnë e kërkojnë me u futur në shkollat e Shqipnis...sado që kemi marrë masa me i futë një pjesë të këtyre djemve ndër shkollat e këtij qarku, kurrsesi nuk po mundemi me u ba ballë drejtimeve të parreshtura...”¹¹² Gati që të gjithë u kthyen, më 1941, në vendlindje, duke vënë, bashkë me kolegët e tyre nga Shqipëria, themelet e arsimit shqip dhe të administratës shqipe në Kosovë.

Që të gjithë mësuesit përqafuluan programin e shoqërisë “Bashkimi” të Avni Rustemit, duke iu bashkuar, kësodore, lëvizjes demokratike në Shqipëri, të cilës i printe në Malësi Bajram Curri. Sipas A. Vokrit, “Formimi i shoqërisë kulturo arsimore “Bashkimi” në Gjakovë u bë me propozimin e Avni Rustemit, i cili në vitin 1924 inicioi çështjen e formimit të shoqërive kulturo-arsimore...degë të kësaj shoqërie formohen në Krumë, Bicaj, Gjakovë dhe gjetiu”¹¹³. Ai pohon, më tutje, se “themelimi i kësaj shoqërie është i lidhur ngushtë me emrat e punëtorëve të shquar të arsimit siç janë: Sali Morina, me vendbanim në Bicaj, e që ishte drejtor i internatit “Kosova”, Ibrahim Kolçi, mësues në Kolgecaj dhe Qamil Luzha, mësues në Krumë. Pa dyshim një kon-

111 Prenk Uli-Qemal Sakajeva, *Asim Vokshi*, “8 Nëntori,” Tiranë, 1979, f. 27. Sipas disa fakteve të reja del se shkolla e parë shqipe në Bujan u hap më 4 janar 1923. Më gjërësisht: S. Matoshi, Një shekull dritë... f.51-52.

112 S. Matoshi, Një shekull dritë... f. 56.

113 A. Vokri, I. Kolçi..., f. 121; Cf. Arkivi Kombëtar i Tiranës, Fondi Prefektura e Kosovës, Dosja Nr. 394, e vitit 1939.

tribut të shquar në këtë shoqëri dhanë edhe punëtorët mësimor si: Hasan Feridi, Jusuf Dushi, Hamdi Jetiu, Hamdi Zajmi, Baba Qazim Bakalli, Osman Shaqiri, Shyqyri Morina dhe Tahir Zajmi, të gjithë me vendbanim në Gjakovë”¹¹⁴.

Ndër nxënësit e parë që kryen shkollën shqipe në Gjakovë ishin Vehbi Meqa, Isa Dautaga, Selman Riza, Qazim Haraqia, Minip Bokshi, Mazllom Rizvanolli etj.¹¹⁵

Ata, të cilët nuk arritën t’i përfundojnë mësimet në Gjakovë kaluan në Shqipëri, ku e vazhduan shkollimin e mëtejshëm si Asim Vokshi, Emin Duraku, Hajdar Dushi, Latif Ymer Jaka etj.

114 Ibid.

115 J. Buxhovi, *Shkëndi e ars. shqip.*

Prof. Dr. Masar RIZVANOLLI

SUMMARY

DEVELOPMENT OF ALBANIAN EDUCATION IN GJAKOVA TILL 1918

Çarshia e Madhe (Big Bazaar) of Gjakova emerged with establishment of first craftsman and craftsmanship production by the end of the 16-century. Turkish chronologist Evlia Çelebiu on 1662 remarks, Gjakova has two thousand homes and 300 shops “of some kind of craft”. Thanks to its geographical positioning and residents agility, pointed out from all writers that visited Gjakova, this dwelling rapidly flourished to a centre of crafts, trade, religious, cultural and education for the region and beyond.

Central part of the general development played Big Bazaar, where all kinds of crafts and trade emerged. In the beginning, trade relations with Shkodra for export and import of goods to European trade centres and to lesser degree with Serbia, Sanjak and Bosnia. Trade to Austria and beyond passed through Serbia. After construction of the railway Thessaloniki – Shkup – Mitrovica transportation of goods commenced through this line.

Economic boom from trading brought construction of hotelier premises known as Hans and Caravansary. Except of primary economic role, Bazaar has played a political – social, cultural, educational and humanitarian role. Craftsman organized into Esnafs, at time when Ottoman authority was in decline, replaced almost all administrative institutions of the ruler relieving legal provisions of the time with legal norms respected by all residents in Gjakova area.

In urbanism aspects, Bazaar represented a model of busy awry road alleys that link spontaneously town neighbourhoods with accentuated architecture inspirational for present architects. While on professional viewpoint it represents a school of beautiful domestic architecture models and skilled anonymous construction master. It is a unique case of

urban entirety completely persevered that lives almost untouched by the modernity. Because of cultural – historical values, science study interest and its size, Bazaar revivification started in 1970. Main north-south road comprises around one thousand metres, with size of 34 thousand square meters. But on 24 March, 1999 Serbian military and paramilitary forces set ablaze savagely Big Bazaar and all of its cultural-historic and religious monuments.

